# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-432602**
VERSIONI

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ministria e Mbrojtjes: 43 vatra zjarri në 24 orë, 13 vijojnë aktive! Cilat janë qarqet më problematike në vend – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/ministria-e-mbrojtjes-43-vatra-zjarri-ne-24-ore-13-vijojne-aktive-cilat-jane-qarqet-me-problematike-ne-vend/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 9 shtator 2026, 08:42:43 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 9 shtator 2026, 08:37:36 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `c52632c20f5cfe67989b941ff367d70ff0e67ba3f5f076387d0fb07c5db65998` |
| TEKSTI | `c9ce61b10ae303aae79017ef43ff166bca675bf01b73a8eff2c215501e6f3835` |
| PAMJA | `a251ebb62e3e4e43ba9ee78952881fcf0208a25cea4d57a6616f4a1498694bfb` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c2d032a4b45475419a1bf13fb4f3f9ca6329162e926482fdbc0118ee5d2b141e` |
| E MËPARSHMJA | `8e7d0391c70cec2d3dbc6ce082480e6a24b6d2f73bc2fc881687eb407efc178f` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c2d032a4b45475419a1bf13fb4f3f9ca6329162e926482fdbc0118ee5d2b141e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

regjistruar 45 vatra zjarri, ndërsa 15 prej tyre vijojnë të jenë aktive. Sipas Ministrisë së Mbrojtjes, 8 vatra janë aktualisht nën mbikëqyrje, ndërsa 22 janë shuar.

Në operacionet për shuarjen e zjarreve janë angazhuar 697 forca operacionale vendore dhe lokale dhe 68 automjete zjarrfikëse. Në mbështetje të tyre, Forcat e Armatosura kanë angazhuar 314 efektivë, 8 automjete zjarrfikëse, një autobot, 29 mjete, 5 autoambulanca dhe një dron. Gjatë 24 orëve janë realizuar edhe 4 operacione me helikopterë.

Për ditën e sotme pritet të vijojë angazhimi i rreth 252 forcave ushtarake, 28 automjeteve, 2 autoambulancave dhe një droni.

Në qarkun Tiranë, zjarri në Malin e Dajtit vijon të jetë aktiv në pyllin e ahut dhe në shkurre, por aktualisht nuk paraqet rrezik për zonat e banuara. Në terren janë angazhuar forca zjarrfikëse, të ADZM-së dhe të Forcave të Armatosura, ndërsa sot operacionit do t’i shtohen rreth 50 forca ushtarake. Vatrat në Kryezi, Malin e Bërzhitës dhe Malin me Gropa janë nën mbikëqyrje.

Situatë aktive paraqitet edhe në qarkun Dibër, ku vijojnë zjarret në Vajkal të Bulqizës, Lundre–Madhesh në Mat, Qafën e Helmes dhe Cerrujë–Mali i Allushit në Klos. Sipas autoriteteve, për këto vatra nuk ka rrezik për zonat e banuara.

Në Lezhë, vatra në Gallatë të Kurbinit vijon aktive në një terren të vështirë, por pa rrezikuar banesat. Operacioni më i gjerë po zhvillohet në zonën Kalivaç–Zimaj–Kashnjet, ku janë angazhuar dhjetëra forca vendore,

ekspertët: Gabimi që na bën të kemi...

NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

efektivë të FA-së dhe mjete të shumta, ndërsa sot pritet mbështetja e rreth 50 forcave ushtarake.

Në qarkun Shkodër, aktive mbeten vatrat në Mnelë të Vogël, Bardhaj–Myselim dhe Malin e Tërbunit. Në Mnelë të Vogël janë raportuar dy banesa në rrezik, të cilat po mbrohen nga forcat zjarrfikëse. Në dy vatrat e tjera nuk raportohet rrezik për zonat e banuara. Forcat e Armatosura do të vijojnë sot mbështetjen me rreth 80 efektivë.

Ndërkohë, në Elbasan vijon aktive vatra në Gurëshpatë të Librazhdit, ndërsa Mali i Qukësit është nën mbikëqyrje. Në Vlorë, zjarri në Qesarat–Mali i Malinës, në Finiq, mbetet aktiv dhe është ndërhyrë edhe me helikopter. Në Fier, Peshtani është nën mbikëqyrje, ndërsa vatra në Çërrilë të Mallakastrës vijon aktive dhe sot do të mbështetet me rreth 30 forca ushtarake.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile vijon monitorimin e situatës në të gjithë territorin e vendit, në koordinim me prefekturat, bashkitë dhe strukturat e Mbrojtjes Civile.

Autoritetet bëjnë me dije se kapacitetet operacionale mbeten në terren dhe në gatishmëri për ndërhyrje, me prioritet mbrojtjen e jetës së qytetarëve, banesave dhe pasurisë.

#MinistriaEMbrojtjes #Zjarre

**Xhuljana Zhuleku**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.
Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



VENDI

**Nis viti i ri shkollor, Skënder Hita mesaz...**

Xhuljana Zhuleku · 20 minuta më parë



VENDI

**Alarmi i rremë për bombë në shkollën...**

Xhuljana Zhuleku · 27 minuta më parë



LIFESTYLE

**"Nuk doja të largohesha, ika duke...**

Xhuljana Zhuleku · 28 minuta më parë



© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.